



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1346 Prot

Patos, më 17/05/2024

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 45, datë 17.05.2024

PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT DHE VLERËS SË PROJEKTIT ME OBJEKT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS VRESHT”, MIRATUAR ME VENDIM TË KESHILLIT BASHKIAK NR. 81, DATË 18.12.2023 “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE DHE BUXHETIT PËR VITIN 2024”

Bazuar në neni 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ekipi i programit të menaxhimit:

KËRKON

1. Ndryshimin e emërtimit të projektit nga “Rikonstruksion i rrugës Vresht” në **“Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagjja e Re”**.
2. Ndryshimin e vlerës së projektit të miratuar në Buxhetin e vitit 2024 nga **32,445,000 lekë në 49,342,439.4 lekë**.
3. Diferenca prej 16,897,439.4 lekë midis vlerës së miratuar në Buxhetin 2024 dhe vlerës së projektit të hartuar do të përballohet brenda tavaneve buxhetore të vitit 2025.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Ermenita Mici

Gazmira Plesati

Silvana Mici

Marsilda Lizaj

Nurke Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 13461 Prot
11

Patos, më 17/05/2024

RELACION PËR PROJEKT-VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT DHE VLERËS SË PROJEKTIT ME OBJEKT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS VRESHT”, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 81, DATË 18.12.2023 “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE DHE BUXHETIT PËR VITIN 2024”

Në zbatim të Buxhetit të Bashkisë për vitin 2024, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 81, datë 18.12.2023, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ka hartuar projektin “Rikonstruksion i rrugës Vresht”. Vlera totale e miratuar për realizimin e këtij projekti ishte 32,445,000 (tridhjetë e dy milion e katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë.

Arsyeja për ndryshimin e emërtimit dhe vlerës së këtij projekti është se gjatë fazës së hartimit të projektit në fjalë është konsideruar e nevojshme të zgjerohet zona e ndërhyrjeve të rikonstruksionit të rrugës me plotësimin e segmenteve lidhëse në brendësi të Bllokut të Vreshtit si dhe plotësimi me rrjetin e nevojshëm të kanalizimeve të ujrave, të cilat fillimisht nuk ishin parashikuar, por rezultojnë një domosdoshmëri për banorët e zonës.

Bazuar në tërësinë e ndërhyrjeve të parashikuara në këtë projekt dhe shtrirjen e tij në zonën e Vreshtit, projekti në fjalë do të duhet të emërtohej “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagjja e Re”, pasi përshkruan më saktësisht zonën e ndërhyrjes.

Qëllimi dhe objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet rritjes së vlerës së projektit është përmirësimi i infrastrukturës rrugore në mënyrë që të përfitojnë nga shërbimi gjithë banorët e zonës së Vreshtit.

Efektet e pritshme nga ky ndryshim janë lehtësimi i aksesit për gjithë banorët e Bllokut të Vreshtit dhe krijimi i kushteve sa më të mira nëpërmjet rrjetit të sistemuar të kanalizimeve, rrjetit të ndriçimit dhe sipërfaqeve të trotuareve.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë:

1. Ndryshimin e emërtimit të projektit nga “Rikonstruksion i rrugës Vresht” në “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagjja e Re”.
2. Ndryshimin e vlerës së projektit të miratuar në Buxhetin e vitit 2024 nga 32,445,000 lekë në 49,342,439.4 lekë.
3. Diferenca prej 16,897,439.4 lekë midis vlerës së miratuar në Buxhetin 2024 dhe vlerës së projektit të hartuar do të përballohet brenda tavaneve buxhetore të vitit 2025.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Ermenita Mici

Gazmira Plesati

Silvana Mici